

Buletin tremujor për Projektin e Binjakëzimit „Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ“ – projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

❖ Çfarë ndodhi midis 15 marsit të vitit 2020 dhe 14 qershorit të vitit 2020?

Ngjarjet më të rëndësishme në këtë tremujor nuk ishin të natyrës politike dhe ekonomike, megjithëse padyshim që do të kenë pasoja afatgjate shikuar nga të dy aspektet.

Bëhet fjalë për pandeminë SARS-KOVID-19, e cila filloi në Kinë në fund të vitit 2019 dhe u përhap në të gjithë botën gjatë tremujorit të parë të viti 2020. Kjo pandemi i detyroi qeveritë të ndërmarrin masa për mbrojtjen e shëndetit publik, që përfshinte kufizime në lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe kapitalit, dhe që gjithashtu ndikuan në realizimin e këtij projekti.

Për të njëjtën arsye, më 18 mars të vitit 2020 u shpall gjendja e jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila imponoi mbylljen e kufijve dhe aeroporteve. Është jashtëzakonisht vështirë të vlerësohet se sa do të zgjasë kriza dhe cilat do të jenë pasojat, por fatkeqësisht në këtë moment kjo krizë shëndetësore dhe shoqërore nuk tregon shenja të një fundi.

Pasi shqyrtuan me kujdes opsionet e mundshme, si rezultat i pandemisë dhe pamundësisë për të zbatuar aktivitetet e projektit, më 18 mars të vitit 2020, drejtuesit e këtij projekti i dërguan Delegacionit të BE-së një propozim për pezullimin e projektit. Ky propozim u miratua dhe projekti u pezullua për një periudhë prej tre muajsh, duke filluar nga **1 prilli i vitit 2020 deri më 30 qershor të vitit 2020**.

Gjatë tremujorit të tretë të realizimit të Projektit, sa u përket aktiviteteve të projektit, në mënyrë virtuale u mbajt vetëm takimi i tretë i Komitetit Drejtues të Projektit më 25 mars të vitit 2020.

Rastësisht, por interesante, e njëjta ditë kishte një rëndësi të madhe për perspektivën Evropiane të Maqedonisë së Veriut, sepse Këshilli Evropian, bazuar në progresin e arritur në zbatimin e reformave dhe përmbushjen e kushteve të vendosura unanimisht nga Komisioni, në qershor të vitit 2018, vendosi t'i hapë negociatat e pranimit me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën nga data 1 prill e vitit 2020 deri në fund të tremujorit të tretë të realizimit të projektit, 14 qershor të vitit 2020, Projekti u pezullua.

Periudha e realizimit të Projektit është vazhduar deri më 14 mars të vitit 2021, d.m.th. për një periudhë të barabartë me periudhën e pezullimit.

Kontakt:

Zyra e Këshilltarit të Përhershëm për Binjakëzim
twinning.nbrnm@gmail.com



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

